



+

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0512**Në ankesën e*****Paditësi/Ankuesi*****L I** nga Prishtina, i përfaqësuar nga **K B**, avokat nga Prishtina,**Kundër*****E paditura*****NSH. "Auto Prishtina"**, (në likuidim), Prishtinë, të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. " Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-0685 të datës 17 prill 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 05 tetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktvendimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-15-0685 i datës 17 gusht 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 29 prill 2015, paditësi e dorëzon një padi në DHPGJS për pagesën e pagave të mbetura e të pa paguara nga NSH "Auto Prishtina", në Prishtinë. Me këtë padi kërkohet nga Gjykata që të detyrohet e paditura të paguaj borxhin kryesor për paga të pa paguara për periudhën tetor 2003- qershor 2014, në shumë prej 12.350,00 euro, si dhe ka kërkuar kamatën ligjore në vlerë prej 3.5 % për çdo vit. Në këtë padi paditësi nuk cek ndonjë vendim të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në padi paditësi pohon se ai vazhdimisht i ka kërkuar pagat nga NSH-ja e paditur në bazë të kontratës së punës dhe atë deri në fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-së për çka ai pohon se e ka pranuar një Njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe mundësinë e paraqitjes së kërkesave tek Autoriteti i Likuidimit. Në padi ai pohon se kishte rezistuar me punëtor të tjerë për uzurpimin e pronës së NSH-së, nga ana e ndërmarrjes private e cila e kishte marrë asetet e NSH-së, me qira, mirëpo as AKP-ja as menagjmenti i NSH-së, dhe as ndërmarrja nuk kanë siguruar funksionim normal të NSH-së, kështu që punëtorët nuk kishin mundësi të punonin pa pengesa për çka punëtorët nuk ndihen fajtor. Bashkë me këtë padi paditësi dorëzon autorizimin e avokatit, dokumentin e regjistrimit të NSH-së në ARBK, Njoftimi drejtuar Autoritetit të Likuidimit për dorëzimin e padisë në Gjykatë, një shkresë të AKM-së drejtuar Drejtorit të kompanisë "Auto Kosova", B S, e datës 18 nëntor 2004, një shkresë tjetër e AKM-së drejtuar drejtorit të "Auto Kosova", B S e datës 19 gusht 2004, një listë të punëtorëve aktiv të cilët nuk kanë marrë paga sipas kontratës së punës e dorëzuar në AKP me 12.09.2014, kontratën e punës të datës 10.10.2003, një deklaratë drejtuar zyrës rajonale të Prishtinës.

Me datë 30 mars 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së lëshoj një urdhër për paditësin me të cilin ka kërkuar që ai ta dorëzoj vendimin e kundërshtuar të Autoritetit të Likuidimit, si dhe Njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës, formularin e kërkesës dhe ndonjë dëshmi tjetër në mbështetje të kërkesës. Në Urdhër paditësi ishte paralajmëruar për pasojat ligjore që mund të lindin për padinë, nëse nuk përmbushen kërkesat e Urdhrit.

Me datë 13 prill 2022, paditësi e dorëzoi një parashtresë si përgjigje ndaj Urdhrit, dhe bashkë me këtë parashtresë ai dorëzon Vendimin E autoritetit të Likuidimit PRN126-0198 të datës 29 prill 2015, që ka të bëjë me kërkesën për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, e jo me kërkesën për paga, një kopje të ankesës të paraqitur ndaj Vendimit PRN126-0198 të datës 29 prill 2015, kopjen e Kontratës së punës, një Deklaratë dhe Autorizimin e Avokatit.

Me datë 21 prill 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në padi. Në mbrojtjen në padi AKP-ja ka pohuar se padia nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë nga neni 70.2 i Shtojcës së LDHP. AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të tregoj se cili nen është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa e paditëses është parashkruar pasi që ajo nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi ti ketë kërkuar këto paga brenda 3 viteve e më së voni nga shtatori i vitit 2003, kur pretendohet se nuk janë paguar pagat nga NSH-ja. Tutje AKP-ja pohon se do ta bëjë me dije Gjykatën se në fakt asetet e ndërmarrjes janë lëshuar me qira për gjatë gjithë periudhës në të cilën paditësja i kërkon pagat. Ndërmarrja nuk ka kryer asnjë nga funksionet e kësaj bazë, por menagjmenti i vetë emëruar ka vjelë të ardhura nga qiradhënia e aseteve të NSH-së, ndërsa edhe lista e paraqitur me ankesë është përgatitur nga ky menagjment i vetë quajtur dhe atë e ka dorëzuar në momentin kur Bordi i AKP-së e morri në shqyrtim vendosjen e NSH-së në likuidim. Ajo listë thjeshtë ka vlerë deklarative dhe nuk mund të shërbej assesi si provë për përfitimin e pretenduar në këtë kërkesë.

Me datë 11 maj 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së lëshoj një urdhër për paditësin me të cilin ka kërkuar që ai ta dorëzoj vendimin e kundërshtuar Autoritetit të Likuidimit. Në Urdhër paditësi është paralajmëruar për pasojat ligjore, nëse nuk plotësohen kërkesat e Urdhrit.

Me date 27 maj 2022 ,paditësi e dorëzoj një parashtrese në DHPGJS-së si përgjigjeje ndaj urdhrit. Me këtë parashtrese ai ka dorëzuar vendimin e Autoritetit

të Likuidimit PRN126-0198 të datës 29 prill 2015, i cili i referohet kërkesës për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, por nuk e ka dorëzuar vendimin e kërkuar me urdhër që ndërlidhet me kërkesën për paga të papaguara për periudhën tetor 2003-qershor 2014.

Me datë 17 gusht 2022, Shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-15-0685, e hedhë si të papranueshme padinë e paditësit. Shkalla e parë e DHPGJS-së ka arsyetuar se nga paditësi me Urdhrin e datës 30 mars 2022 dhe 11 maj 2022, është kërkuar nga paditësi që të dërgon në gjykatë Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, i cili ka të bëjë me kërkesën për pagesën e pagave për periudhën nga Tetori 2003 e deri në Qershor 2014, duke e paralajmëruar paditësi me pasojat ligjore në bazë të nenit 36.2 nënpika 2.5 dhe nënpika 2.6 të LDHP-së, nëse nuk dorëzohet në gjykatë Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Paditësi në Urdhrat është përgjigjur duke dorëzuar Vendimin PRN126-0198 të datës 29 prill 2015, që ka të bëjë me kërkesën për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, dhe disa prova tjera, por nuk e ka dorëzuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit që ndërlidhet me kërkesën për paga të papaguara. Andaj nga këto arsye padia e paditësit për paga është hedhë poshtë si e papranueshme.

Me datë 07 shtator 2022, paditësi e dorëzoi në DHPGJS përmes postës një ankesë kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-15-0685 të datës 17 gusht 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet padia e paditësit si e bazuar, ose lënda të kthehet në rishqyrtim. Për më tepër në ankese, paditësi pohon se Aktvendimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nganeni 182 par.1 dhe 2 pika n të LPK-së, nga se dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin e dhënë në Aktvendim. Tutje ai pohon se e paditura me Listën e puntorëve aktiv në NSH- të cilët nuk i kanë marrë pagat, e kishte pranuar borxhin. Paditësi pohon se dispozitivi i Aktvendimit është i pa kuartë dhe i pa ekzekutueshëm. Në ankesë paditësi pretendon se gjendja faktike nuk është vërtetuar si duhet, duke pohuar se paditësi i kërkon pagat e

papaguara, ndërsa ai ka marrë akontacion të pagesave e jo pagë mujore. Tutje paditësi pretendon se për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike gabimisht janë aplikuar edhe dispozitat materiale.

Me datë 07 nëntor 2022, AKP-ja e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe i përgjigjet ankesës së ankuesit. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se ajo e mbështet në tërësi Aktvendimin e ankimuar të shkallës së I-rë të DHPGJS, ndërsa i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit si të pabazuara. AKP-ja në përgjigje në ankesë pohon se nuk do t'i përsërisë argumentet edhe më herët gjatë mbrojtjes në padi, pasi që kjo do të jetë e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. Andaj nga këto arsye, AKP-ja kërkon që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesave dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 29 prill 2015, përmes postës e ka dërguar një padi në DHPGJS dhe kërkon paga të pa paguara nga NSH "Auto Prishtina" (në likuidim) Prishtinë, për periudhën nga muaji tetor 2003 e deri qershor 2014, në shumë prej 12.350,00 euro.

Me këtë padi nuk është cekur asnjë vendim i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit as nuk është cekur ndonjë numër i vendimit dhe as me padi nuk është dorëzuar ndonjë vendim i Autoritetit të Likuidimit.

Çështja e pranueshmërisë së kësaj padie, të cilën edhe AKP-ja e potencon në mbrojtje në ankesë është adresuar nga ana e Shkallës së I-rë në Aktvendimin e ankimuar.

Shkalla e I-rë e lëshoj dy urdhra për paditësin me datë 30 mars 2022 dhe 11 maj 2022, dhe i kërkoj paditësi të dorëzoi në gjykatë vendimin e Autoritetit të Likuidimit që i referohet pagave të papaguara për periudhën tetor 2003-qershor 2014.

Paditësi me parashtresën e datës 13 prill 2022, ai ka dorëzuar një vendim tjetër të Autoritetit të Likuidimit e jo vendimin e kërkuar. Paditësi ka dorëzuar vendimin PRN126-0198 të datës 29 prill 2015, i cili i referohet kërkesës për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, ndërsa me Urdhër kërkohej nga paditësi, që të dorëzon Vendimin e Autoritetit të Likuidimit mbi pagat e papaguara.

Paditësi edhe me parashtresën e dytë të datës 27 maj 2022, që ishte si përgjigje ndaj Urdhrit të dytë, nuk ka dorëzuar Vendimin e Autoritetit të Likuidimit që ndërlidhet me kërkesën për paga të papaguara për periudhën e cekur. Në vend që të dorëzoi këtë vendim ai ka dorëzuar prova tjera.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë padinë e paditësit për pagat e papaguara, e ka hedh si të papranueshme, pasi që është e qartë se në bazë të nenit 36.2 nënpika 2.5 dhe nënpika 2.6 të LDHP-së, nëse nuk dorëzohet në gjykatë Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit, atëherë padia nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë. Paditësi në bazë të nenit 72.2 të LDHP-së kishte obligim ligjor që me padi të dorëzoi edhe Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij në shkallën e dytë prape dështon që të dërgoi në gjykatë Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit që ndërlidhet me kërkesën për paga. Në ankesë paditësi merret me meritat e

kërkesës ,ndërsa nuk jepe arsye pse ai ka dështuar ta dërgoi Vendimin e kërkuar të Autoritetit të Likuidimit.

Andaj nga këto arsye, ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Prandaj nga se u tha më sipër, në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Paditësi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 20 shtator 2022, në shumë prej 30 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendosë nga Kolegji i Apelit me 05 tetor 2023.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
